

MJAFT!

www.mjaft.org


QEVERISJA E HAPUR E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PROPOZIME PËR PËRMISIMIN E SITUATËS



Norwegian Embassy

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



QEVERISJA E HAPUR E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

Gusht 2022

AUTORË


Aldo MERKOÇI – Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja MJAFT!
Xheni LAME – Menaxhere Programi, Lëvizja MJAFT!





Tabela e përmbajtjes:

1	Hyrje	4
2	Hapja institucionale e Pushtetit Ekzekutiv në Shqipëri	6
2.1	Qeveria e Shqipërisë	7
2.2	Ministritë e linjës	9
2.3	Agjencitë Ekzekutive	11
3	Metodologjia e kërkimit	13
4	Rekomandime për hapa konkretë veprimi	14



Bazuar në metodologjinë për matjen e hapjes institucionale, Lëvizja MJAFT! ka përgatitur këtë punim mbi politikat, në të cilin janë analizuar nivelet e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit ekzekutiv në Republikën e Shqipërisë. Punimi paraqet rezultate të një kërkimi gjithëpërfshirës, bazuar në metodologji shkencore, e krijuar nga anëtarë të rrjetit të ActionSEE¹. Qëllimi i këtij kërkimi është të prezantojë një këndvështrim të përgjithshëm të gjendjes aktuale të pushtetit ekzekutiv, si dhe të kontribuojë në zbatimin e reformave të ndërmarra për administratën publike, të ndikojë në përforcimin e parimeve të mirëqeverisjes dhe të ndihmojë institucionet në zbatimin më eficient të detyrave të tyre operative. Ky dokument përmban rezultatet e hulumtimit të realizuar përgjatë periudhës mars – gusht 2022, si dhe rekomandime për përmirësimin e hapjes institucionale të qeverisë. Duke marrë në konsideratë punën e bërë ndër vite, në partneritet me organizatat e rajonit, disa prej treguesve që masin performancën janë rishikuar dhe ndryshuar në varësi të rezultateve të matura, të cilat prezantonin gjendjen e institucioneve të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe mangësitë që institucionet shfaqin, dhe praktikat e mira në këtë fushë.

Në këtë studim, metodologjia matjes së performancës së institucioneve publike është përmirësuar dhe modifikuar; treguesit e saj janë përshtatur mbi bazën e rezultateve dhe gjetjeve të monitorimit, zhvilluar vitet e shkuara, duke synuar gjenerimin e informacionit që do të kontribuojë në rezultate më të mira të projektit. Qëllimi i përdorimit të treguesve të rinj dhe të përmirësuar është shtimi i një dimensionit të ri në këtë kërkim dhe

REZULTATET

një qasje më efiçente ndaj përmirësimit të hapjes institucionale në vend. Duke zotëruar njohuri, rezultate konkrete dhe analiza të qeverisjes së hapur institucionale, si dhe duke besuar në përmirësimin e punës së institucioneve të pushtetit ekzekutiv në këtë fushë, të ndikuar edhe nga hapa konkretë të prezantuar në udhëzuesit e përgatitur, synojmë të advokojmë për një nivel më të lartë të qeverisë së hapur në Shqipëri. Për këtë arsye, kërkimit të këtij viti i janë shtuar tregues, të cilët advokojnë për standarde më të larta të transparencës proaktive.

Politika e qeverisjes së hapur duhet të jetë një politikë e zbatuar në të gjitha qeveritë dhe duhet të përkufizohet ashtu si politikat e tjera të rëndësishme, dhe jo të vijë si rezultat i një vendimi aktual apo i gjendjes së forcës aktuale në pushtet. Propozimi ynë i adresohet vendimmarrësve të pushtetit ekzekutiv në Republikën e Shqipërisë, në të gjitha nivelet: këshilli i ministrave, ministritë e linjës dhe agjenci ekzekutive. Ky punim mund të jetë i dobishëm për përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe për kolegët e organizatave të shoqërisë civile, të cilët punojnë mbi çështje të tilla. Në mënyrë që të arrihet një dialog publik i cilësive të larta lidhur me këto çështje, si dhe për të siguruar arritjen e parimeve të transparencës së kërkimit, institucionet publike do të informohen mbi të gjitha detajet e kryerjes së tij dhe konkluzionet e përshtatura. Databaza me të dhënat e hapura të mbledhura në kuadër të këtij programi do të jetë e aksesueshme për të gjithë të interesuarit². Jemi në dispozicionin tuaj për të gjitha sugjerimet, kritikën konstruktive dhe diskutimet lidhur me këtë punim!

.....

¹ ActionSEE "Accountability, Technology and Institutional Openness in South Eastern Europe" (<https://actionsee.org/>) është rrjet rajonal organizatash nga vendet e Ballkanit Perëndimor, që kanë ndërtuar Indeksin Rajonal të Hapjes. Për të gjeneruar Indeksin Kombëtar të Hapjes për Shqipërinë është ndjekur e njëjta metodologji, sikurs Lëvizja MJAFT! është pjesë e këtij rrjeti, që prej vitit 2016.

² ActionALBANIA "Accountability, Technology and Institutional Openness in Albania": <https://actionalbania.org/en>

HAPJA INSTITUCIONALE E PUSHTETIT EKZEKUTIV NË SHQIPËRI

Pushteti ekzekutiv në Shqipëri është shënjuar së fundmi nga disa ngjarje, të cilat kanë ndikuar performancën e qeverisë, si dhe marrëdhënien e saj me publikun e gjerë. Në prill të vitit 2021 u mbajtën në Republikën e Shqipërisë zgjedhjet e përgjithshme, rezultati i të cilave vendosi, për herë të parë përgjatë periudhës së tranzicionit, se një parti politike do të zotëronte e vetme mandatin e tretë radhazi. Për rrjedhojë, viti 2022 e gjeti ekzekutivin shqiptar në një situatë pothuajse post-pandemi dhe në rikuperim të ekonomisë së vendit. Situata e emergjencës pandemike ndikoi, sigurisht, në performancën e institucioneve shtetërore, ashtu sikurse edhe në atë ekonomike të Shqipërisë.

Sakaq, këtë vit, qeveria shqiptare shpalli vendimin për t'u bërë vendi i parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili do të mbyllte sportelet fizike të të gjitha shërbimeve shtetërore ndaj publikut dhe biznesit. Që prej 1 majit 2022, shërbimet publike ofrohen përmes portalit qeveritar

³ Portali qeveritar: <https://e-albania.al/>

⁴ Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026: <https://cutt.ly/6MtVAUn>

⁵ Sulmi kibernetik, korrik 2022: <https://cutt.ly/GMtMiVP>

e-albania³. Reforma e digjitalizimit të shërbimeve shtetërore⁴ përfaqëson një hap drejt përmirësimit të nivelit të shërbimit ndaj qytetarit dhe biznesit, por njëkohësisht solli ngritjen e shqetësimeve të shumta për atë pjesë të qytetarëve, që për arsye ekonomike, sociale, apo aftësi ndryshe, nuk mund t'i aksesojnë këto shërbime.

Përgjatë këtij viti, paralelisht me faktorët kombëtarë, edhe situata ndërkombëtare me luftën në Ukrainë, si rrjedhojë e agresionit rus, ndikoi në veprimtarinë vendase. Rritja e kostove të jetesës, si rezultat i kësaj lufte, përfaqësoi situatë emergjence, duke detyruar pushtetin ekzekutiv të rishikojë dhe rialokojë buxhetin e shtetit, me qëllim përshtatjen ndaj realitetit të krijuar.

Së fundmi, aftësia dhe performanca e institucioneve publike për të qenë transparente ndaj qytetarit u lëkund edhe nga sulmi kibernetik i korrikut të këtij viti⁵. Një sulm i drejtuar ndaj disa prej institucioneve më të rëndësishme në Shqipëri, si Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Brendshme, duke përfshirë sistemin TIMS, databazën e Policisë së Shtetit, si dhe institucione të cilat ende nuk dihet nëse janë prekur nga shtrirja e këtij sulmi. Ky sulm është provuar të jetë i drejtuar nga shteti i Iranit. Si pasojë e këtij sulmi, për një periudhë dy javore, faqet e institucioneve publike të Republikës së Shqipërisë ishin të paralizuara, për shkak të rënies së sistemit të serverave të shtetit. Fikja e serverave u krye si masë ndaluese e sulmit. Rezultati i këtij sulmi ka bërë të mundur që një pjesë e të dhënave personale sensitive të qytetarëve shqiptarë të jenë tashmë të aksesueshme nga kushdo.

2.1

HAPJA INSTITUCIONALE E PUSHTETIT EKZEKUTIV NË SHQIPËRI

Këshilli i Ministrave, në këtë hulumtim të rradhës, ka shënuar 67.7% i hapur, si rezultatet e performancës së treguesve të matur. Në kontribut të krijimit të një trendi performance, në matjen e fundit të kryer sipas metodologjisë së ActionSEE për të matur indeksin e hapjes institucionale, qeveria shqiptare ka arritur të plotësojë 68.42% të treguesve. Vëmë re se performanca e këtij institucioni, ndërmjet dy matjeve, ka një diferencë negative prej 0.72 pikë përqindjeje.

Referuar situatës së vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Bosnja & Hercegovina ka shënuar 49.85% të hapjes, Serbia 37.96%, Mali i Zi 58.16%, ndërsa Maqedonia e Veriut 82.71%. Performanca e arritur në këtë hulumtim nga këshilli i ministrave të Republikës së Shqipërisë, e vendos vendin të renditur të dytin në rajon për sa i takon plotësimin të standardeve ndërkombëtare të hapjes institucionale.

Performanca e shtyllave që hulumtimi mat ka shënuar 51.51% transparencë, 79.38% aksesueshmëri, 39.9% efektshmëri dhe 50.59% integritet. Në krahasim me matjen e fundit të vitit 2018, komponenti i transparencës është rritur 4.19 pikë përqindje, ndërsa efekshmëria ka shënuar negativisht 41.92 pikë përqindje, gjithashtu integriteti ka shënuar ulje të performancës me 36.78 pikë përqindje. Për sa i takon publikimit të informacioneve në format open data, këtë vit qeveria ka shënuar 33.79%, ndërsa në rezultatet e fundit ka qenë 34.89%.

TRANSPARENCA

Disa nga dokumentat që mungojnë në faqen zyrtare të Kryeministrit janë raportet që përmbajnë informacion mbi realizimin e planeve vjetore të punës. Edhe pse programi i qeverisë është i publikuar në faqe, për publikun e gjerë është e pamundur të aksesojë dokumente që përmbajnë informacion sesa nga ky program është arritur brenda vitit 2021 nga qeveria.

Edhe pse lista e funksionarëve zyrtarë dhe nëpunësve civilë të kryeministrit, së bashku me jetëshkrimet e tyre, gjenden në seksionin e organikës së këtij institucioni, të dhënat e tyre zyrtare të kontaktit mungojnë.

Në lidhje me mbledhjet e Këshillit të Ministrave, asnjë dokument për këtë sesion nuk është i publikuar në faqe. Kalendarin e mbledhjeve të ardhshme, agjendat, materialet e nevojshme për zhvillimin e mbledhjes së këshillit, minutat e mbledhjeve, si dhe transmetimi në kohë reale i tyre janë

tërësisht të munguara në faqen e qeverisë. Për sa i takon prokurime publike, programi i transparencës së institucionit udhëzon përdoruesit e faqes të drejtohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimeve Publike (APP), si institucioni përgjegjës për mbajtjen e këtyre procedurave. Sakaq, në faqen e kryeministrit nuk mund të gjenden thirrjet administrative për prokurime, vendimet, kontratat e firmosura dhe raportet mbi realizueshmërinë e këtyre kontratave.

Gjithashtu, informacioni buxhetor është i munguar. Përpos ligjit të buxhetit të shtetit që aksesohet në faqe, dokumentat e lidhura me raportimin financiar dhe shpenzimet faktike të vitit, mungojnë. Buxheti i publikuar në një dokument që përmban informacion të kuptueshëm për qytetarët përfaqëson një indikator tjetër të paarrtur nga ky institucion.

AKSESUESHMËRIA

Përmes treguesve që masin ushtrimin e të drejtës së informimit në Republikën e Shqipërisë, ky komponent ka rezultuar dhe në vlerën më të lartë të plotësueshmërisë së institucionit të kryeministrit. Duke qenë se ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" përfaqëson një nga ligjet më të mira në rajon dhe Europë për garantimin e të drejtës së informimit, pjesa më e madhe e standardeve ndërkombëtare të aksesueshmërisë arrihet nga qeveria e vendit tonë, sikurse treguesit e metodologjisë sonë masin kuadrin ligjor të këtij aspekti. Gjithashtu, pasja e një portali qeveritar për open data⁶ dhe një portali qeveritar për shërbimit publike, si e-albania, rrit performancën e institucionit.


Treguesit që kanë ndikuar në mosplotësimin tërësor të këtij komponenti kanë qenë moskthimi i përgjigjes ndaj kërkesës për informacion të dërguar, mungesa e detyrimit ligjor për trajnimin e nëpunësve civilë në fushën e drejtës së informimit dhe mungesa e pjesëmarrjes së institucionit në trajnimet e publikimit të informacionit në formatin open data.

INTEGRITETI

Shqipëria vijon të mos ketë një ligj për të rregulluar aktivitetin e lobistëve, pavarësisht se është rregulluar kuadri ligjor për pasjen e kodeve të etikës dhe ligjit për sinjalizuesit. Gjithashtu, qeveria shënon negativisht në mos publikimin e deklaratave të pasurisë së funksionarëve të shtetit; ky informacion aksesohet nga publiku vetëm përkundrejt kërkesës.

EFEKTSHMËRIA

Në termat e efektivitetit, qeveria shqiptare shënon negativisht në përdorimin e treguesve për matjen e performancës vjetore të punës dhe financiare. Sigurisht që referuar legjislacionit shqiptar dhe procedurave të auditimit, këta tregues janë të zhvilluar nga çdo institucion, por për shkak të mungesës së përgjigjes nga ky institucion, rezultati i këtyre treguesve është 0. Dokumenta të tjerë që mungojnë lidhen me planifikimet afatmesme dhe afatgjata të punës.



.....

⁶ Open data portal: <https://opendata.gov.al/>

Ministritë e linjës të Republikës së Shqipërisë kanë rezultuar 38.91% transparente, 53.08% të aksesueshme, 44% integritet, 40% efektshmëri. Rezultati total i Indeksit Kombëtar të Hapjes Institucionale të Ministrive është 54.05%. Në krahasim me matjet e fundit të vitit 2018, ministritë kanë një ulje të lehtë në performancë, me 0.45 pikë përqindje. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural vijon të mbetur institucioni me arritjen më të lartë të standardeve të hapjes institucionale me 63.65%, ndërsa ministria me rezultatin më të ulët, mbetet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me arritjen e 38.83% të treguesve. Vihet re se rezultatet e institucioneve nuk kanë ndryshim të ndjeshëm ndërmjet dy matjeve, të këtij viti me atë të vitit 2018, duke çuar në konkluzionin se jo shumë është bërë në fushën e transparencës për të përmirësuar situatën.

Referuar situatës së vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Bosnja & Hercegovina ka shënuar 38.5% të hapjes, Serbia 46.82%, Mali i Zi 48.17%, ndërsa Maqedonia e Veriut 58.56%⁷. Për rrjedhojë, Shqipëria renditet në vendin e dytë në rajon për performancën e ministrive.

Ministria me përqindjen më të lartë të publikimit të dokumentave në format open data është Ministria e Arsimit dhe Sportit, me 44% të rezultatit total, ndërsa me rezultatin më të ulët është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me 18.21%. Renditja e Ministrive të linjës sipas performancës bazuar në matjet e bëra gjatë vitit 2022, si në vijim:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 63.65%,
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit 60.77%,

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 60.77%,
4. Ministria e Mbrojtjes 56.27%,
5. Ministria e Drejtësisë 55.55%,
6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 55.37%,
7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë 55.19%,
8. Ministria e Punëve të Brendshme 52.14%,
9. Ministria e Kulturës 48%,
10. Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme 48%,
11. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit 38.83%

Për sa i takon komponentit të transparencës, dokumentat më të munguara, çështje që hasen më së shumti, janë dokumentat në lidhje me buxhetet institucionale dhe procedurat e prokurimeve publike. Ministritë adresojnë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave si institucioni përgjegjës për buxhetin e shtetit dhe transaksionet e thesarit për pagesat institucionale. Njëjtë ndodh me procedurat e prokurimeve publike, ku ministritë të drejtojnë në faqen e APP, si institucioni përgjegjës për realizimin e thirrjeve dhe kontratave. Ndërkohë që të gjitha ministritë kanë zbatuar detyrimin ligjor për të dërguar në kohë raportet e tje vjetore financiare ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ministria me më shumë informacion buxhetor të publikuar në faqen e saj zyrtare është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ndërsa për procedurat e prokurimeve publike, Ministria e Mbrojtjes publikon më shumë informacion për planet, thirrjet dhe vendimet, pasuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, të cilat publikojnë

.....
⁷ ActionSEE, viti 2022: <https://index.actionsee.org/>

krahas thirrjeve në faqen e APP, edhe planet vjetore të prokurimeve.

Në lidhje me komponentin e aksesueshmërisë, vihet re një rritje performance për këto institucione. Është rritur numri i publikimit të draft-ligjeve për konsultim publik dhe materialeve mbështetëse për realizimin e këtyre proceseve. Ashtu sikurse buxheti dhe prokurimet, edhe konsultimet publike janë “të centralizuara” për të ndodhur në një platformë të vetme qeveritare . Treguesit që kanë shënuar pozitivisht në këtë hulumtim kanë qenë ata që kanë matur publikimin e raporteve të proceseve konsultative me grupe interesi dhe vendimin për t’i integruar komentet e këtyre grupeve në aktet finale, së bashku me arsyetimit. Si dhe, rritja e publikimit të Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), gjë e cila ka shënuar negativisht në hulumtimet e mëparshme.

Ajo që vihet re më së shumti në publikimet e faqeve publike të institucioneve është mungesa e dokumentave apo raporteve të aktivitetit të tyre të përditshëm administrativ. Edhe pse informacioni i publik tanimë paraqitet më i strukturuar, perceptimi i parë që merret nga faqet e institucioneve është promovimi i punëve dhe aktiviteteve të titullarëve të tyre, më shumë sesa transparenca institucionale.

vihet re një rritje performance për këto institucione. Është rritur numri i publikimit të draft-ligjeve për konsultim publik dhe materialeve mbështetëse për realizimin e këtyre proceseve. Ashtu sikurse buxheti dhe prokurimet, edhe konsultimet publike janë “të centralizuara” për të ndodhur në një platformë të vetme qeveritare⁸.

.....

⁸ Platforma e konsultimeve publike: <https://konsultimipublik.gov.al/>

Treguesit që kanë shënuar pozitivisht në këtë hulumtim kanë qenë ata që kanë matur publikimin e raporteve të proceseve konsultative me grupe interesi dhe vendimin për t’i integruar komentet e këtyre grupeve në aktet finale, së bashku me arsyetimit. Si dhe, rritja e publikimit të Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), gjë e cila ka shënuar negativisht në hulumtimet e mëparshme.

Ajo që vihet re më së shumti në publikimet e faqeve publike të institucioneve është mungesa e dokumentave apo raporteve të aktivitetit të tyre të përditshëm administrativ. Edhe pse informacioni i publik tanimë paraqitet më i strukturuar, perceptimi i parë që merret nga faqet e institucioneve është promovimi i punëve dhe aktiviteteve të titullarëve të tyre, më shumë sesa transparenca institucionale.



2.3 AGJENCITË EKZEKUTIVE

Krahasimisht me vitet e shkuara, ku hulumtimi përfshinte vetëm një kampionim të agjencive ekzekutive në Republikën e Shqipërisë, në këtë hulumtim janë monitoruar 39 agjencitë ekzekutive që janë aktualisht në funksion. Në këtë monitorim, agjencitë ekzekutive kanë arritur rezultatin total të 25.08% të plotësisimit të treguesve të hapjes institucionale. Ky rezultat është thujse 36% më pak nga arritja e vitit 2018, duke shënuar një rënie shumë të ndjeshme të niveleve të transparencës së këtyre institucioneve. Referuar situatës së vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Bosnja & Hercegovina ka shënuar 40.49% të hapjes, Serbia 31.2%, Mali i Zi 40.82%, ndërsa Maqedonia e Veriut 41.54%⁹. Pra, agjencitë ekzekutive në Shqipëri performojnë më ulët se nga homologet e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Më konkretisht, transparencja është në nivelet 20.66%, aksesueshmëria 30.88%, integriteti 11.18% dhe efektshmëria 20.53%. Në këtë rezultat, kanë ndikuar edhe institucionet të cilat nuk kanë faqe zyrtare, por edhe numri i ulët i institucioneve që kanë kthyer përgjigje ndaj kërkesës së dërguar për informacion zyrtar. Edhe njëherë shikohet ngurtësia e këtyre institucioneve për të qenë të aksesueshme dhe transparente ndaj palëve të interesuara, duke i adresuar çështjet e transparencës tek institucionet nga të cilat ata varen.

Performancën më të lartë për agjencitë ekzekutive e përfaqëson Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, me 46.94% të treguesve të plotësuar. Në thujse të njëjtën performancë paraqiten edhe Agjencia Kombëtare për Planifikimin Territorial, Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore, Agjencia Shqiptare e

Zhvillimit të Investimeve, si dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave. 18.42% e agjencive nuk kanë faqe zyrtare, tregues i cili është pozitiv krahasimisht me matjet e fundit (në 2018, rreth 29% e institucioneve nuk kishin faqe). Renditja e performancës së agjencive ekzekutive, sipas rezultatit të arritur prej tyre, është si më poshtë:

1. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile 46.94%
2. Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit 41.75%
3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore 40.88%
4. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve 40.23%
5. Agjencia e Prokurimeve Publike 40.23%
6. Agjencia e Menaxhimit të Kredive 38.5%
7. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore 38.5%
8. Agjencia e Sigurimit të Depozitave 38.07%
9. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 36.34%
10. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural 36.34%
11. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 36.34%
12. Agjencia Kombëtare e Mjedisit 35.26%
13. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara 34.17%

⁹ ActionSEE, viti 2022: <https://index.actionsee.org/>

- | | |
|--|--|
| 14. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 34.17% | 31. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje 11.26% |
| 15. Agjencia Kombëtare e Diasporës 32.87% | 32. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara 10.37% |
| 16. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës nga BE 32.47% | 33. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 5.63% |
| 17. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit 31.58% | 34. Agjencia e Shërbimit të Sportit 1.73% |
| 18. Agjencia Telegrafike Shqiptare 31.58% | 35. Agjencia e Zhvillimit të Territorit 0% |
| 19. Agjencia Kombëtare e Turizmit 30.28% | 36. Agjencia Kombëtare Bërthamore 0% |
| 20. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 29.84% | 37. Agjencia Kombëtare e Falimentit 0% |
| 21. Agjencia Kombëtare e Bregdetit 29% | 38. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve 0% |
| 22. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë 28.76% | 39. Agjencia Qendrore e Ekstensionit Bujqësor dhe Shërbimit Veterinar 0% |
| 23. Agjencia e Menaxhimit të Koncesioneve 27.25% | |
| 24. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore 27.25% | |
| 25. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore 26.82% | |
| 26. Agjencia Shtetërore e Kadastrës 26.81% | |
| 27. Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve 26.82% | |
| 28. Agjencia e Eficencës Energjitike 25.3% | |
| 29. Agjencia e Trajtimit të Pronës 24.22% | |
| 30. Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara 16.86% | |

Edhe në rastin e agjencive ekzekutive, dokumentat që lidhen me transparencën buxhetore dhe të procedurave të prokurimeve publike janë ato të cilat mungojnë në mënyrë të përsëritur. Raportet që kanë lidhje me ushtrimin e veprimtarisë, si dhe pjesëmarrja në trajnime që rrisin kapacitetet e institucionit në fushën e të drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale, mbrojtjes së sinjalizuesve dhe parandalimin e korrupsionit, janë disa nga dokumentat që shënojnë negativisht performancën e këtyre institucioneve.

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

3

Qeverisja e hapur përfaqëson një kusht kyç të demokracisë pasi kjo u lejon qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrje efektive dhe pasjen e institucioneve të përgjegjshme për politikën të cilat ato ndjekin. Ndërkombëtarisht, institucionet ndërmarrin aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e transparencës së tyre dhe llogaridhënien të qytetarët. Indeksi Kombëtar i Hapjes Institucionale të pushtetit ekzekutiv është ndërtuar në qëllim të përcaktimit se në cilën shkallë qytetarët marrin dhe kuptojnë informacionin e institucioneve të tyre. Indeksi Kombëtar i Hapjes Institucionale mat shkallën në të cilën institucionet publike janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, duke u bazuar në katër parimet bazë, të cilat janë:

1) Transparenca 2) Aksesueshmëria 3) Integriteti dhe 4) Efektshmëria

Parimi i transparencës përfshin informacionin organizativ, buxhetin dhe procedurat e prokurimeve publike, të cilat janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara. Aksesueshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për akses të lirë në informacion, duke përmirësuar disponueshmërinë e informacionit përmes mekanizmave të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. Integriteti

përbëhet nga mekanizmi i parandalimit të korrupsionit, mbajtjen e kodit etik dhe rregulloret e lobimit. Parimi i fundit, Efektshmëria i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga institucionet. Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet, si dhe shembujt e praktikave të mira, këto parime janë zhvilluar më tej përmes treguesve specifikë cilësorë dhe sasiorë, të cilët janë vlerësuar në bazat e: aksesueshmërisë së informacionit në website-t zyrtare të institucioneve, shqyrtimin e kuadrit ligjor për çështje të veçanta, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione. Përmes rreth 200 treguesve, kemi matur dhe analizuar hapjen institucionale të institucioneve të pushtetit ekzekutiv dhe janë mbledhur më shumë se 1748 të dhëna (këshilli i ministrave, 11 ministritë e linjës dhe 38 agjenci ekzekutive). Matjet janë kryer gjatë periudhës Mars – Gusht 2022.

REKOMANDIME PËR HAPA KONKRETË VEPRIMI

Duke iu referuar standardeve ndërkombëtare të hapjes institucionale, institucionet e ekzekutivit duhet të përmirësojnë performancën e tyre kryesisht në komponentët e aksesimit dhe transparencës, në përputhje me ligjin në fuqi nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit". Më konkretisht, institucionet publike duhet të angazhohen në fuqizimin e kapaciteteve të Koordinatorëve për të Drejtën e Informimit, me trajnime përkatëse dhe qëndrueshmërinë e tyre në përgjegjësinë e caktuar, si aktorë të rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të transparencës. Përgjegjshmëria ndaj kërkesave prej aktorëve të interesuar për informacion publik duhet të rritet nga institucionet publike, duke zbatuar afatet ligjore, si dhe nenet rregulluese të ligjit për të Drejtën e Informimit; zvogëlimi i burokracive dhe rritje proaktiviteti.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të angazhohet kryesisht në rritjen e transparencës së veprimtarisë së Këshillit të Ministrave, përmes publikimit të agjendave dhe procesverbaleve të zhvillimit të mbledhjeve. Rekomandim thelbësor dhe i vazhdueshëm mbetet krijimi i ligjit për lobingun, si një formë integrale e pjesëmarrjes moderne të qeverisjes dhe si e tillë, duhet të rregullohet ligjërisht.

Ministritë e linjës në Republikën e Shqipërisë duhet të fokusohen më shumë në publikimin e dokumentave që përmbajnë informacion në lidhje me veprimtarinë e tyre administrative, në përputhje me fushën e tyre të veprimit, duke shmangur mbizotërimin e publikimeve që lidhen më së shumti vetëm me figurat dhe aktivitetet e drejtuesve të këtyre institucioneve. Publikimi i dokumentave buxhetorë dhe atyre të procedurave të publikimeve publike duhet të konsiderohet prioritet për t'u publikuar në faqet zyrtare

të tyre dhe jo në platforma të qëndëruara. Agjencitë Ekzekutive të Republikës së Shqipërisë mbeten ende të ngurta për të qenë të hapura ndaj palëve të interesuara. Një nga rekomandimet më të rëndësishme është rritja e trajnimeve për personelin përgjegjës për zbatimin e të drejtës së informimit mbi relevancën e ligjit dhe penaltitetet administrative të cilat përfshijnë edhe këto agjenci, si entitete publike, pavarësisht se nën varësinë e cilit institucioni publik ato janë; krijimi i një kulture të përgjithshme ku çdo institucion publik buxhetor të jetë i përgjegjshëm për të qenë proaktiv dhe transparent.



MJAFT!

www.mjaft.org



Norwegian Embassy



www.actionalbania.org

